



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 9 SHTATOR 2017**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 09. SEPTEMBRA 2017. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR  
2017**

## **Rendi i ditës**

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

## **Dnevni red**

1. Izbor Vlade Republike Kosova

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar mysafirë,  
Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Greg Delavi,  
Përfaqësues të Bashkimit Evropian,  
Përfaqësues të KFOR-it,  
Ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Republikën e Kosovës,  
Përfaqësues të bashkësive fetare,  
Të gjithë ju të tjerë të pranishëm në këtë seancë,  
Si dhe përfaqësues të medieeve,  
Konstatoj se në seancë janë të pranishëm 70 deputetë, që nënkupton se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8 shtator 2017, me kërkesë të 45 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, i ka propozuar Kuvendit këtë rend dite:

### **1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Të nderuar deputetë,  
Presidenti i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 95, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i ka propozuar Kuvendit kandidatin për kryeministër të Republikës së Kosovës zotin Ramush Haradinaj.

Kandidati për kryeministër, zoti Ramush Haradinaj, ka propozuar parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2017-2021.

Ftoj para jush kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta marrë fjalën. Urdhëroni, zoti Haradinaj!

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Qytetarë të Kosovës,  
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Greg Delavi,  
E nderuar përfaqësuese e BE-së, Natalija Apostolova,  
I nderuar komandant i KFOR-it, kor diplomatik,  
Të gjithë ju prezentë të ftuar,  
Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar që do t'i propozoj sot,

Qeveria që e kërkon besimin tuaj, e që më është besuar mua ta udhëheq, trashëgon një situatë vështirë në vend, me planin e brendshëm dhe të jashtëm, me korrupsionin endemik në të gjitha nivelet institucionale dhe shoqërore, me një gjendje të rëndë në planin ekonomik, me një situatë të rëndë në planin social, situatë tepër të ndjeshme me besimin në institucione, deri në zbehjen e shpresës për perspektivën ekonomike në vend.

Gjendja në sektorët veç e veç, pa i mohuar të arriturat e caktuara, edhe duke u shprehur falënderim të gjithë atyre që kanë kontribuar në këto të arritura, prapë është e vështirë.

Shëndetësia e arsimit nuk janë mirë, bujku i Kosovës ndihet i lënë vetëm, të rinjtë vështirë arrijnë të punës, ndërsa për femrën kosovare bëhet edhe më e vështirë gjetja e një vendi pune, e veçanërisht për atë që jeton në zona rurale.

Sipërmarrësit tanë të Kosovës, sidomos ata të vegjël e të mesëm, e kanë shumë vështirë të bëjnë biznes në krahasim me vendet rreth nesh.

Marrim përsipër si Qeveri që të përballemi me këtë gjendje, që ekonomia jonë të ketë rritje me mobilizim të resurseve dhe thithje të investimeve nga jashtë, që të hapen vende të punës, e që gjendja sociale të rregullohet për të gjithë me punësim.

Që shëndetësia të shërohet dhe të kemi arsim cilësor në vend, që aftëson tregun tonë, tregun e punës.

Të nderuar deputetë,

Para vetes keni disa orientime programore, një dokument. Mirëpo programin e Qeverisë do ta sjellim në afat të caktuar, në seancën e radhës, pas konstitutimit të komisioneve.

Para se ky program qeverisës të silltet te ju dhe para se të votohet, do t'i nënshtrohet një diskutimi publik të shoqërisë civile, të gjithë atyre që kanë interesim.

Mirëpo, që të mund të kemi një program qeverisës të suksesshëm, duhet ta studiojmë, pra të incizojmë gjendjen nëpër sektor veç e veç, në mënyrë që nisja të jetë e saktë.

Të dashur deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Për Republikën e Kosovës është tepër i rëndësishëm konsolidimi i rendit dhe i ligjit.

Duke i falënderuar për punë të madhe dhe sakrificën e të gjithëve që marrin pjesë dhe që ndihmojnë në rend, ligj dhe siguri, megjithatë na pret shumë punë.

Kosova rrezikohet nga rreziqet e vjetra dhe të reja, terrorizmi botëror na rrezikon të gjithëve pa dallim.

Kosova në planin e sigurisë do të ndihet e sigurt vetëm si anëtare e NATO-s, do ta aftësojmë Kosovën për anëtarësim në NATO. Duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe në partneritet me aleatët.

Perspektiva ndërkombëtare e Kosovës është e vështirësuar, anëtarësimi i Kosovës nëpër institucione ndërkombëtare është detyrë jona, në NATO, në OKB dhe në BE.

Perspektiva evropiane e Kosovës: Kosovës i është stërzgatur rruga për BE dhe si e tillë shihet aq e largët sa mund ta humbë kuptimin e saj. Do ta ndryshojmë këtë, Kosova nuk shkon në BE, po bëhet BE, ajo bëhet BE duke e zbatuar MSA-në, duke u operacionalizuar në veprime qeverisëse.

Të nderuar deputetë,

Institucionet e BE-së: Standardet pas statusit dikur kanë qenë MSA-ja jonë, ata që e dinë, ato janë kryer në kohë rekord, ne do të punojmë në zbatimin e MSA-së dhe do ta fitojmë statusin e kandidatit për Kosovën.

Republika e Kosovës ka në themel flijime të shumta, ka shumë sakrificë të qytetarëve tanë, shqiptarëve kudo që janë, për liri. Po ashtu, me lidhjen e lirisë sonë ka lindur edhe një miqësi që është unike, një miqësi e veçantë, ajo me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Do ta forcojmë këtë miqësi, është e përhershme dhe jo vetëm për kohët e qeta.

Rajoni: Kosova i merr përgjegjësitë e veta në rajon si faktor stabiliteti, do të dialogojë me të gjithë.

Dialogun me Serbinë e kemi pa alternativë, edhe pse kemi një histori tragjike. S'mund ta ndryshojmë faktin se jemi fqinjë.

Kosova ndien nevojën për dialog për popull, e jo vetëm për elitën politike. Do të hap një dialog të brendshëm për të kuptuar ndjenjën e qytetarëve, të popullit në tërësi për këtë dialog. Kjo ndodh në mënyrë që përfaqësuesit politikë të mos kenë shkëputje me popullin. Nëse shkëputja ekziston, atëherë hendeku thellohet.

Të arriturat e dialogut duhet të burojnë nga populli, në mënyrë që edhe të mund të zbatohen.

Kolegë të nderuar,

Qeveria e Kosovës para jush, ajo që u prezantua sot, përbëhet nga parti të ndryshme, nga shumë parti, i falënderoj për besim. Përbëhet nga komunitetet, i falënderoj për besim, të gjithë. Dëshiroj t'u drejtohem qytetarëve serbë të Kosovës me pak fjalë në gjuhën serbe.

Albanci kao jedan od najstarijih naroda koji žive na ovim prostorima, uvek su poštovali ostale narode, njihove vrednosti, jezik, religiju i sve što čini njihov identitet.

Albanci su uvek poštovali manjine. Upostavili smo međusobno poverenje, tako da danas živimo jedni uz druge zajedno. Nastojaćemo da razvijemo poverenje i sa Srbima. Dostojanstvo i poštovanje svih koji žive na Kosovu, biće moj moto.

Po kthehem në gjuhën time, në gjuhën shqipe.

Që të gjithë ne, e secili prej nesh, e ndiejmë peshën e misionit qeverisës që e kemi para vetes.

Besoni në këtë Qeveri që ka njerëz të profileve të ndryshme, të ekspertëve e të arriturave të tyre. Këta mund ta kthejnë shpresën, mund ta kthejnë qytetarin tonë në partner, edhe të atyre që sot nuk kanë shpresë e mendojnë të ikin nga vendi.

Deputetë të nderuar,

Të gjithëve jua kërkoj votën për Qeverinë që më është besuar ta udhëheq në mënyrë që t'i shërbej qytetarit të Kosovës. Faleminderit!

Dëshiroj dhe e kam nderin të lexoj po ashtu përbërjen e kabinetit.

Përbërja e kabinetit është si vijon:

Udhëhiqet nga unë, Ramush Haradinaj,

Zëvendëskryeministër i parë, zoti Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër Fatmir Limaj, zëvendëskryeministër Dalibor Jevtiq, zëvendëskryeministër Dardan Gashi,

Ministër i Forcës së Sigurisë, Rrustem Berisha,

Ministër i Infrastrukturës, Pal Lekaj,

Ministër i Financave, Bedri Hamza,

Ministër i Shëndetësisë, Uran Ismajli,

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi,

Ministre e Integriteteve Evropiane, Dhurata Hoxha,

Ministër i Drejtësisë, Abelard Tahiri,

Ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj,  
Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica,  
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqeri Bytyqi,  
Ministër i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani,  
Ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli,  
Ministër i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj,  
Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka,  
Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj,  
Ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi,  
Ministër për Kthim dhe Komunitete, Dalibor Jevtiq,  
Ministër i Administratës së Pushtetit Lokal, Ivan Teodosijeviq,  
Ministër i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar,  
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo dhe  
Ministër i Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri.

Faleminderit, kryetar!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Haradinaj!

Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.  
Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar PDK, AAK, “Nisma” që të marrë fjalën.  
Zoti Enver Hoxhaj e ka fjalën.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Ndërkohë zoti Hoxhaj e merr fjalën, duke pasur parasysh se ende nuk jemi të pajisur me kartela, kisha kërkuar nga grupet parlamentare që diskutuesit të lajmërohen.

**ENVER HOXHAJ:** I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,  
Zoti nënkryetar Xhavit Haliti dhe nënkryetarë të tjerë të Kuvendit të Kosovës,  
Zoti mandatar, zoti Ramush Haradinaj,  
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Përfaqësues të të gjitha subjekteve politike në këtë Kuvend,  
Sot jemi mbledhur në këtë Kuvend të Kosovës që ta zbatojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës pas zgjedhjeve të 11 qershorit. Është dashur kohë derisa të formohen këto institucione dhe është dashur kohë derisa ta kemi Kuvendin e Kosovës dhe ta kemi Qeverinë e Kosovës, e cila po formohet sot.

Dëgjuam mandatarin për kryeministër, zotin Haradinaj dhe vijat e tij programore dhe, natyrisht që zoti Haradinaj tha që do ta ketë një program shumë më të plotë qeverisës, të cilin do t'ia prezantojë këtij Kuvendi të Kosovës.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Natyrisht që ne jemi me mandat të qytetarëve të Kosovës në këtë institucion shumë dinjitoz, por Qeveria e ardhshme nuk duhet të shihet si një qeveri vetëm e disa subjekteve politike, nuk duhet të shihet vetëm si një qeveri, e cila do të udhëhiqet nga një individ, por do të shihet si një qeveri, e cila do t'i shërbejë çdo qytetari të Kosovës, edhe atyre të cilët i kanë votuar këto parti politike, edhe ata të cilët kanë pasur një qëndrim tjetër për këto subjekte politike, të cilat e formojnë Qeverinë. Prandaj, kjo do të jetë Qeveri e çdo qytetari.

Natyrisht që prioritet mbi prioritetin mbetet stabiliteti i brendshëm politik i vendit. Ajo çka e ka karakterizuar Kosovën çdo herë ka qenë sa stabiliteti politik, po aq edhe kohezioni i brendshëm politik, social e kulturor, të cilin ky vend e ka treguar historikisht, por edhe në vitet e fundit.

Së dyti, reformat e brendshme do të jenë reforma që do të duhej mbi të gjitha të orientohen rreth përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarit dhe kjo përfshin punën, e cila do të duhej të ndodhë në sektorë të shumtë.

Natyrisht që Qeveria do ta ketë një program të plotë, por program më i mirë reformator i Qeverisë, ku po ftoj çdo subjekt politik që në të ardhmen të japë kontributin, është Programi Kombëtar i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kjo do të jetë korniza e veprimit tonë si subjekte politike, të cilat do ta ndërtojnë këtë qeveri.

Prioritet mbi prioritetet mbetet krijimi i vendeve të reja të punës, zhvillimi ekonomik dhe sjellja e investimeve të huaja, me që brenga kryesore për vendin është papunësia dhe ekonomia. Ekonomia dhe ekonomia do të jetë prioritet i dorës së parë të kësaj qeverie dhe zoti Haradinaj e ka mbështetjen e plotë të Partisë Demokratike të Kosovës, natyrisht të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të "Nismës" dhe të subjekteve të tjera politike.

Vendi ynë po lëviz nga një fazë e përmbylljes së shtetndërtimit në një fazë të ndërtimit të një shoqërie të re.

Por, më lejoni t'ju them që sot, në pesë muajt e ardhshëm ne do ta festojmë 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dhe kanë mbetur disa sfida, të cilat kemi nevojë për mbështetje nga deputetë të pozitës dhe të opozitës.

Shndërrimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në forca të armatosura të Kosovës, me mbështetje amerikane, me mbështetje atlantike, me mbështetje evropiane, është kyç, meqë Kosova nuk mund ta nënshkruajë Marrëveshjen e Programit Partneritet për Paqe pa e pasur ushtrinë e saj me mandat të mirëfilltë.



Po ashtu, zbatimi i MSA-së dhe marrja e statusit të kandidatit do të jetë prioritet ynë gjatë viteve të ardhshme, sikur edhe dialogu me Serbinë, i cili do të duhej të sigurojë njohje të ndërsjellë dhe anëtarësim të Kosovës në OKB.

Unë dola këtu që në emër të Grupit tonë Parlamentar t'i ofroj mbështetje të plotë zotit Haradinaj. Vijat e tij programore të Qeverisë janë të qarta. Do ta kemi një debat të plotë në atë moment kur do ta kemi edhe një program të plotë qeverisës. Por dua që zotit Haradinaj dhe Qeverisë së tij të dëshiroj sukses dhe dua që këtë Qeveri ta shohë Qeveri të tij çdo qytetar i Kosovës, meqë do t'u shërbejmë të gjithëve. Ne deri më 11 qershor kemi pasur dallime për atë se si e shohim të ardhmen e vendit, por tash e tutje duhet të jemi unikë se si do të duket Kosova gjatë viteve të ardhshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Hoxhaj!

Tani radhën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Lëvizja "Vetëvendosje", zoti Glauk Konjufca.

**GLAUK KONJUFCA:** Të dashur mysafirë të kësaj seance,  
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Ne e dëgjuam ekspozitën e platformës qeverisëse që e bëri i nominuari për kryeministër, zoti Ramush Haradinaj, dhe ishte një program fare i shkurtër qeverisës. Ishte i shkurtër, jo pse ishte i thukët, por ishte i shkurtër sepse ishte i varfër dhe meqenëse është kështu, e meqenëse i mësuam edhe emrat, ndonëse nuk po e shohim këtu asnjërin, propozoj që meqenëse e kërkoi edhe votën në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës për ta mbështetur Qeverinë e tij, ne pajtohemi me të, le të dalë Qeveria Haradinaj në votë tash dhe këtu.

Pra, ne e paraqesim njëfarë lloj mocioni, mocioni të jetë që Qeveria Haradinaj të votohet në këtë moment. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Tani e ka radhën përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës. Kështu shkruan, më vjen keq, zoti Avdullah Hoti, pavarësisht që flas për koalicionë parazgjedhore.

**AVDULLAH HOTI:** Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar qytetarë,  
Kor diplomatik,  
Çfarë lloj Qeveria do të votohet sot në Kuvendin e Kosovës, më së miri tregon ekspozita që u dha nga mandatori për kryeministër dhe emrat e njerëzve që u prezantuan për këtë Qeveri.

Prandaj, unë e mbështes mocionin që ky propozim dhe kjo Qeveri të hedhet menjëherë në votim përpara deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Lista serbe? Nuk është këtu. Nuk po lajmërohet askush.

Atëherë Grupi Parlamentar “6+”, zonja Myfera Shinik, apo zoti Albert Kinolli. Urdhëro, fjala për ju!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar kor diplomatik,

Medie,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar “6+”, i cili përbëhet prej 4 komuniteteve, përkatësisht nga komunitet turk, boshnjak, rom dhe ashkali e përkrah mandatarin për formimin e Qeverisë së zotit Ramush Haradinaj, si dhe programin qeverisës.

Duke pasur parasysh gjendjen e vështirë që u cek edhe më herët në ekonomi, shëndetësi, arsimim, gjendjen socio-ekonomik, procesin e integritit të personave të riatdhesuar, punësimin, si dhe respektimin e 10% të përfaqësimit të komuniteteve në institucionet publike, këto janë disa nga sfidat të cilat na presin të gjithëve dhe këtë Qeveri, si dhe ndarja e buxhetit, përmirësimi i gjendjes aktuale të komuniteteve pakicë, të gjitha këto janë sfida që me zotin Haradinaj dhe Qeverinë që do të udhëhiqet nga ai do të arrijmë t'i zbatojmë dhe ta përmirësojmë gjendjen aktuale të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të komuniteteve në tërësi.

Unë i dëshiroj punë të mbarë zotit Ramush Haradinaj si kryeministër dhe Kabinetit qeveritar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

E kemi një situatë e cila është e re. Në bazë të Rregullores, unë duhet të procedoj. E kemi pasur një propozim nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” që ta kemi një mocion.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e Kosovës, edhe Alternativa e mbështetin se grup parlamentar.

Tani a ka mundësi ta kemi deklarin e “6+” dhe të PDK-së, AAK-së dhe “Nismës”.

Grupi Parlamentar PDK, AAK, "Nisma" ta kemi qëndrimin, në të njëjtën kohë... Ju e dhatë propozimin, a është mirë t'i pyesim apo hiç? Jo, ju s'e pyetni askënd, por duhet t'i pyesim. Zoti Hoxhaj, në emër të PAN-it, pastaj edhe "6+", qëndrimin thjeshtë, se janë grupe parlamentare. Urdhëro, në qoftë se e do, merre fjalën!

Edhe një herë mundesh, në qoftë se ke nevojë ta qartësosh, në qoftë se nuk e kanë pasur të qartë, e kanë tash. Zoti Hoxhaj, urdhëro!

ENVER HOXHA: Zoti kryetar, faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar PDK, AAK, "Nisma" dhe të gjitha komuniteteve kërkoj që të vazhdojmë debat, meqë,... merreni më qetë, merreni më të relaksuar..., nuk mund të ndryshohet brendapërbrenda. Po çfarë mocioni?!... Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, AAK-së dhe "Nismës", kërkoj nga ju që të vazhdojmë me debat. Nuk ka nevojë të shkojë as në votim, por vazhdojmë me debat.

I ftoj deputetët të cilët janë të interesuar për fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: A ka mundësi vetëm të kemi qetësi në sallë? A ka mundësi edhe deklarimin e Grupit Parlamentar të "6+"? Jemi duke shkuar në bazë të procedurave... Zoti Hoti, a ka mundësi, ta kemi edhe "6+", e pastaj Kujtimi, nënkryetari, e ka kërkuar fjalën. Zoti Kinolli, a ka mundësi?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar "6" mendon se është e drejtë e çdo deputeti që lirshëm të debatojë dhe mendoj se Kuvendi është vend i debatit.

Ne si "6+" e përkrahim mendimin e të gjithë deputetëve, të cilët janë për të vazhduar debati dhe mendoj se debati duhet vazhduar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti nënkryetar, fjala për ju, pastaj zoti Konjufca e ka fjalën. Kisha pasur dëshirë vetëm ta kemi një mbarëvajtje. Urdhëro, nënkryetar! zoti Lekaj, po ashtu u lajmërua.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Deklarimet e grupeve parlamentare janë formale, janë të domosdoshme, por po ashtu është e domosdoshme që në bazë të Rregullores ju së pari të procedoni, d.m.th. ta paraqitni para seancës dhe seanca të deklarohet për mocionin që e paraqiti shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe të cilin e përkrah edhe grupi ynë parlamentar. Do të thotë, s'mund të diskutohet a do të debatojmë a jo, sepse së pari duhet të deklarohemi me votë për mocionin procedural. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm pak, a ka mundësi? Po Glauk, fjala do të jetë për ju, a ka mundësi vetëm pak?

Në ndërkohë që jeni duke folur, i kam tetë emra para vetes. Vetëm pak, a ka mundësi vetëm pak? Në qoftë se dëshironi ta përcillni seancën, Rregulloren, e në qoftë se doni ta bëni ju vetë ligjin, unë pastaj në mënyrë arbitrare mund dhe në momente të caktuara edhe ndaj juve ta bëj të njëjtë, por askush, as unë, nuk kam të drejtë... Askush në këtë Kuvend nuk ka të drejtë t'ia ndalë askujt fjalën. Se po ta bëja të kundërtën, kolegët e opozitës do të kishin thanë s'ke të drejtë. Janë Ahmet Isufi, Blerim Kuçi, Time Kadrijaj, Shkumbin Demalijaj, Teuta Haxhiu, Rasim Selmanaj, Pal Lekaj, Rrustem Berisha. E kanë kërkuar fjalëh Milaim Zeka, Haxhi Shala... Më fal Xhevahire. Urdhëro Glauk, edhe një herë!

GLAUK KONJUFCA: Zonja dhe zotërinj,

Kjo është e jashtëzakonshme. Unë e dëgjova shumë mirë të nominuarin për kryeministër, zotin Haradinaj. Doli këtu dhe na e kërkoi votën. E kërkoi votën e këtij Kuvendi, i prezantoi emrat, tha "ju lutemi, na votoni!". Unë nuk po bëj asgjë, vetëm po e çoj deri në fund kërkesën e tij. Bile po bëj mocion për t'i ndihmuar zotit Haradinaj që ai të zgjidhet, të dalë në votim dhe të krijohet sa më shpejt Qeveria e Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj, jemi vonuar shumë. Programi i tij ishte aq mahnitës, sa na la pa tekst. Ne duhet të shkojmë drejt në votim. Pse jo, ta kemi Qeverinë e Kosovës dhe të shkojmë përpara. Ju lutemi, jemi vonuar shumë. Zgjedhjet kanë qenë më 11 qershor, të mos harrojmë.

Kështu që unë po parashtroj mocion. Mocioni është, ju lutem, hidheni në votim Qeverinë Haradinaj. Edhe vetë ky e kërkoi, më duket.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën. Po, po, do të shkojmë deri në fund, s'ka nevojë të nguteni fare. S'ka nevojë për asgjë.

BILALL SHERIFI: Në emër të PAN-it, e pranojmë mocionin... Ngadalë, ngadalë, a po bëjmë lojë? Në emër të PAN-it, e pranojmë mocionin, por nuk ka mocion që flet për sekonda se kur duhet të votohet. Jo, jo, jooo... Tash ne kërkojmë pauzë që të na vijjnë deputetët... Aaaaaa! A po sheh? Pra, mocion tash në sekonda nuk ka. Ma gjeni diku në Rregullore ku shkruan duhet të votohet tash. Ma gjeni!

Ndërsa, mocion po. Po mocion ka - heqim dorë nga debati. Po. Pra, për mendimin tim dy grupet parlamentare nga ky moment kanë hequr dorë nga debati. Nuk ekziston në asnjë vend në botë ku t'i shtron mocion që duhet të votohet në sekondë. Kaq!Faleminderit!

KRYETARI: A ka mundësi që kryetarët e grupeve parlamentare, 15 minuta pauzë dhe të konsultohemi bashkë. A ka mundësi 15 minuta? A doni? 15 minuta nuk e lëshojmë fare, a ka mundësi të afroheni? Në qoftë se doni 15 minuta pauzë, që dëshironi konsultohemi. Mos e lëshoni sallën, ju kisha lutur. 15 minuta pauzë, konsultohuni!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në vazhdimin e seancës, jemi në propozimin nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” për një mocion procedural për ndaljen e debatit. Propozimi është, kini parasysh, për hir të korrektësisë së opinionit publik, e jo e kësaj pjese të luftës politike që e bëjmë mes nesh, votimi i parë, votohet vetëm për ndalje të debatit.

Votimi i dytë, për hir të qytetarëve tanë, është votimi, i cili ka të bëjë me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Do të thotë, kemi dy votime. Që nga fillimi, votimi i parë është votimi, i cili ka të bëjë vetëm me ndaljen e debatit. Votimi i dytë është votimi, i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me Kabinetin dhe mandatarin e Qeverisë së ardhshme të Republikës së Kosovës.

Jemi në pjesën e votimit. Urdhëro, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”! Ngadalë, jemi para qytetarëve të këtij vendi, të mos krijojmë skena. Kemi një propozim, i cili ka qenë publik, s’ka qenë i mbyllur dhe tash e hapëm.

GLAUK KONJUFCA: Desha t’i them dy gjëra lidhur me mocionin, të cilin ne e propozuam para tri orësh.

E para, ju të PAN-it mësohuni me një parim elementar të demokracisë, mocionet votohen kur i paraqet parashtruesi, jo kur do Kadri Veseli, as kur do Lista Serbe, ky është parimi elementar i demokracisë dhe i parlamentarizmit. Kur e ndërpreu këtë seancë, kryeparlamentari tha: “Do të kemi 15 minuta pauzë”. Deri tani kanë kaluar dy orë e gjysmë, kjo nuk është fer. Kjo është shkelje e demokracisë në Kuvendin e Kosovës.

E dyta, ju nuk e di a e morët vesh që mocionin e paraqita vetëm me një qëllim, që ta demonstroj në mënyrë praktike varësinë e Qeverisë së PAN-it prej Listës Serbe. Vetëm ky ka qenë qëllimi i parashtrimit të mocionit tim. Kështu që konsideroj që ky mocion e ka përmbushur qëllimin e vet, e ka demonstruar në mënyrë praktike qysh kjo qeveri edhe për ta caktuar madje edhe orën e mbajtjes së seancave plenare do ta ktheni kokën nga Beogradi dhe me gojë hapur ta dëgjoni Gjuriqin kur po thotë se duhet të jetë ora e mbajtjes së seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë derexhe e keni prurë ju Kosovën, kështu që, zoti kryetar, konsideroj që mocioni e ka kryer qëllimin e vet dhe tërhiqemi nga ai.

KRYETARI: Pal Lekaj, urdhëro!

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Dola këtu për ta përmbushur dëshirën e mëparshme të kërkuar nga miku im Glauk Konjufca.

Nëse e keni pasur për të bërë fushatë elektorale dhe që të luani me rregulla të Kuvendit, më besoni që kjo nuk thërret për një unitet çfarë ne po e kërkojmë. Nuk thërret për një të mirë të Kosovës çfarë ne po e kërkojmë. Ne jemi të thirrur këtu në Kuvend, e kemi votën e qytetarëve që të punojmë për të mirën e Kosovës dhe të jemi në shërbim të qytetarëve, të forcojmë shtetin e Kosovës dhe të mos bëjmë këtu politikë, sepse po më duket që sot ka ardhur fundi i politikës suaj dhe unë kërkoj nga kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës që të propozojë mocionin për debat. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm pak, jemi para qytetarëve të këtij vendi, kemi ecur në të njëjtën procedurë si herën e kaluar, kërkoj deklaratimet e grupeve parlamentare. Tani kemi nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nismës” propozim të njëjtë, pasi Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosja” u tërhoq, mocion procedural për ndërprerje të debatit dhe kalim drejtpërdrejt në votim.

Lëvizja “Vetëvendosje”, cili është qëndrimi juaj? Jemi duke folur për rregullat, të cilat duhet të respektohen, kjo është e tëra.

GLAUK KONJUFCA: Kur unë e paraqita mocionin dhe ju vendosët në mënyrë arbitrare që ta anashkaloni dhe të mos e qitni fare në votim, unë mendoj që është shkelur Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Tash nëse e qitni në votim, e unë po e tërheq, sepse unë jam parashtruesi i këtij mocioni, atëherë ju sërish e shkelni Rregulloren, dyfish po e shkelni. Herën e parë se nuk e qitët kur kam kërkuar unë, herën e dytë se nuk po e tërhiqni kur po kërkon parashtruesi. Parashtruesi e nxjerr edhe e tërheq mocionin e vet kur do ai.

KRYETARI: Ju lutem, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës...

I nderuar zoti Lekaj, ju e keni bërë propozimin, ok! Ne jemi në procedurë tash, s'mund ta bart Rregulloren...

AVDULLAH HOTI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është bërë më se e qartë pas katër-pesë orësh prej se ka filluar kjo seancë për mënyrën se si po themelohet Qeveria e Kosovës. Nuk dëshiroj të përsëris, tanimë e ka të qartë secili qytetar i Kosovës pa përjashtim që është qeveri që diktohet nga vullneti i Beogradit.

Ju e shkelët Rregulloren, neni 50 i Rregullores, duke mos lejuar që ai mocion atëherë të futet në votim. Ai që e propozoi, tash e tërhoqi, unë besoj që nuk do vazhdoni me shkelje të tilla të Rregullores qysh në seancën e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të korrektësisë, më 2014 e kemi pritur në Rashkë kur është zgjedhur kryeministër Isa Mustafa, njëjtë. Kjo është ajo çka qytetarët le ta dinë, kjo praktikë si vetë kolegët tanë të partive politike po e krijojnë, njëjtë do të veprojnë edhe “Vetëvendosja”. Urdhëro, “6+”! Pal, e ke nxjerrë propozimin, s’ka më.  
“6+”!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës!  
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e zotit Pal Lekaj. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë, urdhëro zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Debat nuk jemi duke bërë, por duhet t’i sqarojmë faktet dhe jo t’i shtrembërojmë. Qeveria e Kosovës tash e dy vjet ka pasur 87 vota, të gjitha minoritetet kanë të drejtë kushtetuese dhe kanë qenë të mirëpritura si pjesë e qeverisë.

Gjashtë muaj të tërë nuk kanë qenë pjesë e institucioneve, kanë pasur vendin aty, i kemi respektuar plotësisht, por ka funksionuar Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës pa asnjë problem. Askënd nuk e kemi pritur kur kemi themeluar atë qeveri, prandaj kryetar i Kuvendit, ju kisha lutur që të leni këtë lloj sjelljeje dhe të jeni korrekt me qytetarët dhe me deputetët e Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Jemi në pjesën procedurale të Rregullores, e votojmë mocionin procedural propozuar nga Pal Lekaj për ndërprerjen e debatit dhe kalim në votim për mandatarin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Janë 112 deputetë në sallë. Kush është për?

Kush është kundër?

A abstenon dikush? Edhe pse në bazë të asaj çfarë i kam numrat, nuk mund të ketë.

Janë 112 deputetë në sallë, por vetëm proceduralisht.

62 deputetë e votojnë për mocionin procedural për ndërprerjen e debatit propozuar nga Pal Lekaj dhe 50 janë kundër. Do të thotë, kalon mocioni procedural.



Zoti Avdullah Hoti në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Nëse ju mendoni që të procedoni kështu me punën e Kuvendit, është për keqardhje. Ne do të kërkojmë edhe nga Lëvizja “Vetëvendosje” të mbledhim nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme, ku do të debatohet në detaje për ekspozenë e mandatarit, për Kabinetin që është paraqitur para qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Kandidatë për kryeministër, përkatësisht mandatar, a ka mundësi që të prezantoni përbërjen e Kabinetit qeveritar, duke i ftuar një nga një anëtarët e Qeverisë?

MANDATARI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar Veseli,

I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Grek Delavy,

Përfaqësuese e BE-së, Natalia Apostolova,

Komandant i KFOR-it,

Kor diplomatik,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeverisës,

E kam për nder të propozoj para jush përbërjen e Qeverisë që më është besuar ta udhëheq, e për të cilën ju njoftova edhe më herët, por më lejoni t’i thërras një nga një kolegët e mi, me të cilët do t’i shërbejmë qytetarit dhe vendit në mandatin qeverisës që na besohet.

- Zëvendëskryeministër i parë, zoti Behgjet Pacolli,
- Zëvendëskryeministër Enver Hoxhaj,
- Zëvendëskryeministër Fatmir Limaj,
- Zëvendëskryeministër Dalibor Jevtiq,
- Zëvendëskryeministër Dardan Gashi,
- Ministër i Forcës së Sigurisë, Rrustem Berisha,
- Ministër i Infrastrukturës, Pal Lekaj,
- Ministër i Financave, Bedri Hamza,
- Ministër i Shëndetësisë, Uran Ismajli,
- Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi,
- Ministre e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha,
- Ministër i Drejtësisë, Abelard Tahiri,
- Ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj,
- Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica,
- Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqeri Bytyqi,
- Ministër i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani,
- Ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli,

- Ministër i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj,
- Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka,
- Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj,
- Ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi,
- Ministër për Kthim dhe Komunitete, Dalibor Jevtiq,
- Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijeviq,
- Ministër i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar,
- Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo dhe
- Ministër i Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri.

KRYETARI: Në qoftë se ka mundësi, Kabineti qeveritar, të cilët janë deputetë, se na duhen për vota, të jenë të dalluar mundësisht që janë në Kabinetin qeveritar, e nuk janë deputetë, le të largohen në një anë të gjithë, pastaj kur të votohet e ka pak të vështirë Administrata t'u dallojë.

Në anën e majtë të dalin të gjithë që nuk jeni deputetë nga Kabineti qeveritar, ju lutem.

Deputetët, të cilët janë kandidatë për ministra, në anën e djathtë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka një rregull procedurale, të cilën do ta respektojmë për herë të parë, për t'i ikur çdo keqkuptimi. Për ministrat e propozuar nga radhët e komunitetit joshumicë, të cilët nuk janë deputetë, kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të komunitetit joshumicë.

Do të thotë, për të kaluar, për të marrë miratimin këta ministra, duhen 11 deputetë të Kabinetit joshumicë, nga 20 deputetë sa votojnë për.

I lus 20 deputetët, të cilët janë të komunitetit joshumicë që me ngritje dore të deklarohen për ministrat e propozuar, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatoj se me 19 vota për, kundër nuk ka pasur, as abstenim, miratohen kandidatët e propozuar për ministra, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit.

Tani, të nderuar kolegë deputetë, votojmë për Kabinetin qeveritar në tërësi. Lus deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që me ngritje dore të deklarohen për Kabinetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës!

Kush është për?  
Kush është kundër?  
Kush abstenon?

Konstatohet se me 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës. Urime!

Ju lutem, e kemi edhe një procedurë, vetëm për respekt. Ministrat t'i zënë vendet e tyre, ju kisha lutur!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Tani është ceremonia e betimit të anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ftoj kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat t'i zënë vendet e tyre, si dhe të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë. Do të kemi intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës.

*(Intonimi i himnit)*

Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili anëtar i Qeverisë para vetes dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht. Për të përmbushur këtë detyrim, ftoj anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ngritën në këmbë për të dhënë betimin. Lus kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta lexojë tekstin e betimit dhe pas leximit të tekstit të betimit nga kryeministri, të gjithë anëtarët e Qeverisë së bashku shqiptojnë fjalën "betohem".

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

#### Betimi i Qeverisë

"Ne anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, betohemi solemnisht që me përgjegjësi, përkushtim dhe me ndershmëri do t'i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke e zbatuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci, në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor edhe të gjithmbarshëm të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Betohemi". Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që me një fjalë rasti t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, vetëm pak! Kam një vërejtje, kryeministër, a ka mundësi një moment! A ka mundësi edhe një herë, jemi para qytetarëve tanë, Administrata, derisa e kemi bërë numërimin, tani kemi një reagim të kolegut deputet, janë 61 vota për votimin e mandatarit dhe Kabinetit qeveritar të Republikës së Kosovës për, 1 ka abstenuar.

Atëherë, 61 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë për. 1 ka abstenuar.

Zafir Berisha, kërkojmë falje, koleg. Administrata e ka bërë numërimin e tillë. Do të thotë, me 61 deputetë është zgjedhur Qeveria e Republikës së Kosovës, kryeministri dhe ministrat.

Kryeministër, kjo nuk është diçka që ka të bëjë me Qeverinë, kërkojmë falje. Në emër të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, urime! Jashtë po bëjnë festë. Urdhëro, merre fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kolegë deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli!

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeverisës,

Unë s'i kam dy fjalë, e kam një fjalë: nëse doni ta dëgjoni atë që jua thashë, jua them prapë, por një fjalë e kam, një fjalë do ta kem gjithnjë: punë! Na priftë e mbara në punë! Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës, me këtë e mbyll seancën e sotme dhe i dëshiroj suksese Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kryeministrit, zotit Ramush Haradinaj, në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe të programit qeveritar.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*